

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtares Fatime Dermaku, në çështjen penale kundër të pandehurit S. M., nga P., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II nr. 679/15, të datës 23.02.2016, për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par 6, lidhur me par 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tutje KPRK-së), duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 11.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET- kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II nr 679/2015, e datës 23.02.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: **S. M.**, i biri i R., i lindur me datën *data e lindjes*,,, në P., me vendbanim në rrugën "...", nr..., ku edhe jeton, me numër personal identifikues numri personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 19.01.2015, rreth orës 10:50, në rrugën F. K.-P., e pikërisht në afërsi të pompës së derivateve "P. C.", i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes", ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit *target*..., në kundërshtim me nenin 42.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, ndërmerr veprimin e ndërrimit të shiritit nga i majti në të djathtë, ku me pjesën anësore të përparme të djathtë e godet automjetin e markës "Fiat", ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit *targat*..., në pjesën e pasme të majtë, të cilën e drejtonte tani i dëmtuari B. K., me ç'rast shkaktohet aksident me dëme materiale dhe lëndime trupore.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.6, lidhur me par 1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit të sipërpërmendur dhe neneve 41,43,46 të KPRK-së si dhe neneve 365 e 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 € (dyqind pesëdhjet Euro)**, të cilin i dënuari **S. M.** obligohet ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet euro (20 €), gjobë.

I dënuari dënimin e shqiptuar me gjobë mund ta paguajë me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet i dënuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, dhe atë, për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit rrugor shumë prej dyzet euro e tetë dhjetë e tetë centë (40.88) euro, për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej njëzet e tre euro dhe gjashtëdhjetë cent (23.60) euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej njëzet (20) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

I dëmtuari: B. K., me vendbanim në rrugën "...", në F. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën, me shenjën PP. nr 679/2015, të datës 23.02.2016, e ka akuzuar S. M. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1, të KPRK-së, dhe njëherësh, ka kërkuar dhënien e urdhërit ndëshkimor, me arsyetimin se ekzistojnë prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. U., të datës 21.01.2016; Mendimi dhe Kontatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Ing. i dipl. F. B., të datës 20.05.2015; deklaratat e palëve të përfshira në aksident; Skica dhe foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par 2, pika 2.1 dhe 2.6, të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

P.nr. 985/16, datë 11.10.2017

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatime Dermaku,

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.